



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:021239

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05781789

C-IV-14-7619

Parashtruesi i kërkesës

Z U fshati R, Gjakovë

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP) (NSH “Ereniku-Prodhitaria Primare” në Likuidim) Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 5 qershor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ029-0233 datë 18 nëntor 2014.**
- III. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 23 dhjetor 2014, pranë DHPGJS-së, ankuesi parashtroj kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PEJ029-0233 datë 18 nëntor 2014 (në tekstin e mëtuftjeshëm Vendimi), me të cilin kërkesa për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 500.00 (pesë zero zero) Euro, për periudhë të pacaktuar, ndaj N.SH “Ereniku-Prodhitaria Primare”, është refuzuar pasi që ishte parashtruar pas kalimit të afatit të caktuar ligjor.

Ankuesi, kundërshtoj mënyrën e njoftimit të Agjencisë mbi likuidimin e NSH të publikuar në mjetet e informimit nga arsyet se i njëjti jeton në një lokalitet-fshat kur mjetet e shkruara të informimit ishin të pa çastshme dhe se i njëjti njoftim është dashur të publikohet edhe me anë të mjeteve si ato televizive apo radiostacioneve.

Nga këto arsye, ankuesi konsideron se kërkesa e tij është dashur të konsiderohet si e afatshme dhe se refuzimi i kërkesës përbën shkelje të drejtave të punëtorëve të parapara sipas ligjeve pozitive në Kosovë, Kushtetutës dhe Konventave ndërkombëtare.

Nga gjitha arsyet i propozoj gjykatës që kërkesa tij, mbi pagat, të aprovohet.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës ankuesi parashtroj kopjen e kërkuar të Vendimit të AL, i cili fillimisht nuk i është bashkangjitur kërkesës për rishikim-ankesës.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 12 shkurt 2024, parashtroj përgjigjen.

AKP e kundërshtoj në tërësi pohimet e ankuesit si të pabazuara. AKP fillimisht pohoj se kërkesa kreditore është parashtruar jashtë afatit mbi parashtrimin e kërkesave. AKP pohoj se AL me rastin e vendosjes ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP gjithashtu pohon se ankesa nuk përmban argumentet e saj ligjore, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP si dhe Ligjit për procedurën kontestimore -LPK. Nga të gjitha arsyet e cekura, AKP-ja propozon që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe që Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur kopja e Vendimit të AL.

Përgjigja e AKP, përmes urdhrorit të gjykatës, ju dorëzua ankuesit me 10 shkurt 2024.

Ankuesi nuk parashtron përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi e ka dorëzuar kërkesën në AL të Agjencisë jashtë afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP për parashtrimin e kërkesave kreditore. AKP kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të N.SH, sipas vendimit të Bordit të AKP datë 7 maj 2014, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të N.SH “Ereniku” – Prodhimtaria Primare (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 13 gusht 2014.

Ankuesi kërkesën e tij pranë AL, sipas Vendimit të AL, e kishte parashtruar me datë 29 gusht 2014.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te AL e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKP. Ankuesi nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te AL, si pranë AL ashtu edhe pranë gjykatës.

Pretendimet ankimore rreth publikimeve të njoftimit mbi likuidimin gjykata i konsideron si të pabazuara për faktin se AL respektivisht Agjencia ka vepruar ashtu siç parashihet edhe sipas dispozitës së nenit 49 të Ligjit për AKP me Shtojcën e saj, mbi publikimet e njoftimeve dhe shpalljeve publike.

Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pa bazuar, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në DHPGJS kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kërkesë është nën shumës prej 1,000 Euro.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar